

"CILËSIA NË ARSIM"

PËRCEPTIMI I NXËNËSËVE RRETH
PËRMBAJTJES, PROCESIT DHE MJEDISIT MËSIMOR

PRIZREN

**SCHÜLER
HELFFEN
LEBEN**

KYC | KOSOVAR
YOUTH COUNCIL


KNK
Këshilli i Nxënësve të Kosovës
Student Council of Kosova



Të drejtat e autorit © 2022. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

"PERCEPTIMI I NXËNËSVE TË SHKOLLIMIT TË MESËM TË LARTË PËR PËRMBAJTJEN, PROCESIN DHE MJEDISIN MËSIMOR"

RAPORTI I DETAJUAR PËR KOMUNËN E PRIZRENIT

Këshilli Rinor Kosovar
Rr. Kroi i Bardhë, nr.81, Dardani
Prishtinë 10000, Kosovë
kyckosova@gmail.com
+383 (44) 96 45 75

Autorë: Alex Klaus Matz, Dardana Fetahu
dhe Diar Hajrizi

Dizajni: Ditjon Fetahu

Grumbullimin e të dhënave në terren:
Grupi i Monitoruesve të Rinjë (YMG)

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Fuqizimi i Këshillit të Nxënësve të Kosovës", me mbështetje të fondacionit Gjerman, Schuler Helfen Leben (SHL) dhe implementuar nga Këshilli Rinor Kosovar (KYC). Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

09

Të gjeturat
kryesore

12

Hyrje

15

Qëllimi dhe
Objektivat

15

Metodologjia

22

Rezultatet
Sasiore

41

Rezultatet
Cilësore

44

Diskutimi

44

Procesi
Mësimor

45

Mjedisi
Mësimor

47

Përmbajtja
Mësimore

51

Kufizime

52

Referencat

53

Shtojcat I & II

SHKURTESAT

APShK Asocacioni i Psikologëve Shkollorë të Kosovës

KAM Klubi për Arsim më të Mirë

KNK Këshilli i Nxënësve të Kosovës

KD Këshilli Drejtues i KNK

KDSh Këshilli Drejtues i Shkollës

KYC Kosovar Youth Council - Këshilli Rinor Kosovar

MAShTI Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

SHL Schüler Helfen Leben

ShML Shkolla e Mesme e Lartë

UA Udhëzimi Admnsitrativ

ABSTRAKT

Krahas raportit tashmë të lansuar mbi “Perceptimin e nxënësve të shkollave të mesme lidhur me përmbajtjen, procesin dhe mjedisin mësimor të arsimit” për Kosovën në përgjithësi; këto raporte të detajuara për komunat duhet të ofrojnë një kuptim më të saktë të situatës aktuale në terren.

TË GJETURAT KRYESORE

- 42,6% e nxënësve raportuan se të paktën disa nga mësimdhënësit ushtrojnë dhunë fizike ndaj nxënësve.
- 27,1% e nxënësve kanë përjetuar ose dëshmuar ngacmime të nxënësve nga mësimdhënësit.
- 69% e nxënësve kanë qenë dëshmitarë të bullizimit të mësimdhënësve ndaj nxënësve.
- 67,4% e nxënësve thanë se ndonjëherë ndikohen nga nga fyerjet e mësimdhënësve.
- 60,5% e nxënësve deklarojnë se ka përleshje të nxënësve me njëri-tjetrin më shumë se një herë në javë.
- 58,1% raportuan të kenë qenë dëshmitarë të ngacmimeve seksuale mes nxënësve.
- 89,9% raportuan se nxënësit bullizojnë njëri-tjetrin në shkollë.
- 41,9% e nxënësve në këtë hulumtim kanë raportuar se nuk ka psikolog në shkollën e tyre.
- 88,4% e nxënësve të përgjigjur deklaruan se nuk ka ujë të ngrrohtë në banjo.
- 92,2% raportuan gjithashtu mungesë të pecetave në banjo.
- 59,7% e nxënësve raportuan standarde johigjienike në banjot e shkollës.
- Në 52,7% të rasteve, nxënësit thonë se nuk ka rampë për nxënësit me nevoja të veçanta.
- 89,9% thonë se nuk ka banjo të qasshme për nxënësit me nevoja të veçanta.
- 25,6% e nxënësve raportuan se shkolla e tyre nuk ka bibliotekë ndërsa e atyre që kanë bibliotekë, 63,5% nuk kanë bibliotekar.
- 39,6% e nxënësve deklaruan se numri i librave në këto biblioteka nuk është i mjaftueshëm.
- 80,6% e nxënësve kanë deklaruar se ka gabime drejtshkrimore në tekstet shkollore që përdorin dhe 37,3% kanë gjetur gabime faktike në librat e tyre shkollorë.
- 8,5% e nxënësve raportuan se librat e tyre shkollorë nuk kanë informacion të përditësuar në to.

HYA

RJE

HYRJE

Këshilli Rinor Kosovar (KYC) është organizatë jo-qeveritare që aspirojnë të punojë drejt ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë përmes promovimit të iniciativës, mbështetjes së të rinjve, angazhimit të vajzave dhe djemve në procese vendimmarrëse, fuqizimit të kapaciteteve të tyre, përfaqësimit të zërit rinor, promovimit të edukimit të vetë organizuar dhe mbështetjen e zhvillimit të politikave rinore. Të rinjtë, pra, janë motori i organizatës me të cilët ne synojmë të rrisim cilësinë në arsim. Një ndër format kryesore të punës drejt sigurimit të cilësisë së edukimit në vend është angazhimi në krijimin dhe funksionalizimin e këshillave të nxënësve në shkolla dhe mirëmbajtjen e strukturës, e cila përfaqëson nxënësit e shkollave të mesme të larta në Kosovë, Këshillin e Nxënësve të Kosovës.

KYC, në vitin 2005 ka themeluar strukturën më të madhe përfaqësuese të nxënësve të shkollave të mesme të larta – Këshillin e Nxënësve të Kosovës. Përbëhet nga 106 përfaqësues nga 106 shkolla të mesme në 30 komuna të Kosovës. Kjo strukturë kombëtare përfaqëson të gjithë nxënësit e shkollave të mesme, mbron interesat dhe të drejtat e nxënësve dhe bashkëpunon me zyrtarë, prindër, profesorë dhe institucione të tjera arsimore në të mirë të të gjithë sistemit arsimor.

Sipas nenit 23 të Statutit të Këshillit të Nxënësve të Kosovës, anëtarët e Këshillit Drejtues (KD) të KNK-së zgjidhen nga Kuvendi i KNK-së me anë të votimit nga ana e përfaqësuesve të secilës komunë. Kjo zgjedhje zhvillohet në fillim të vitit shkollor, dhe KYC-i vazhdon tutje punën direkt me të përzgjedhurit, ndërsa indirekt me çdo nxënës tjetër në shkollat e mesme të larta të Kosovës. KYC në bashkëpunim me strukturat e lartpërmendura si dhe me Klubin për Arsim më të Mirë (KAM), ka arritur të publikojë hulumtime e analiza të ndryshme, dhe të organizojë iniciativa avokuese, qysh nga viti 2005. Një prej produkteve me të cilën KYC-i krenohet është edhe raporti mbi qëndrimet dhe/ose perceptimet e Këshillit të Nxënësve të Kosovës rreth cilësisë së Arsimit në Kosovë.

I pari raport i këtij lloji është publikuar në vitin 2010, i cili ka marrë për bazë perceptimin e nxënësve për të matur cilësinë e arsimit në Kosovë. Ky raport ka qenë nismë e mirë sa i përket rrugës së hulumimit të cilësisë pasi përmes të dhënave të mbledhura nga nxënësit janë identifikuar shumë sfida. Tutje, në vitin 2016, të nxitur nga studimi i vitit 2010, KYC u angazhua që të përcaktojë cilësinë në arsim për tri kategoritë kryesore: përmbajtja mësimore, procesi dhe mjedisi mësimor. Në këtë raport u përdor metodologji e trefishtë pasi që u përdor pyetësori, intervista dhe analiza ligjore të arsimit parauniversitar për të studiuar cilësinë në arsim me fokus në fushat e lartpërmendura.

Ky raport tutje ofroi rekomandime drejt iniciativave dhe aktiviteteve që duhet ndërmarrë për avancimin në edukim, sipas perspektivës së nxënësve, duke avokuar kështu që nxënësit të konsiderohen partnerë në përpjekjet e përmirësimit të cilësisë në edukim.

Disa nga të dhënat interesante, të rëndësishme dhe alarmante rreth përmbajtjes, procesit dhe mjedisit mësimor që dolën nga ky raport (2016) janë si në vijim:

- Tekstet e librave, nuk janë në përputhje me kurrikulën, përmbajnë gabime faktike dhe nuk janë të ri-freskuar me informacione nga zbulimet e reja.
- Ekziston mungesë e librave sidomos për lëndët e shkollave profesionale.
- Ekziston mungesë e laboratoreve dhe kabineteve funksionale në shkolla.
- Nxënësve nuk i'u mundësohet zgjedhja e lëndëve zgjedhore.
- Organizohen kurse private nga mësimdhënësit/et për lëndët që ligjërojnë në shkollë.
- Mungesa e semaforëve, vijave të këmbësorëve, policëve të shtrirë dhe mos-rrethimi i shkollës i bën nxënësit të mos ndihen të sigurtë.
- Ekziston mungesë e infrastrukturës adekuate në shkollë (banka, dritare, dyer etj).
- Shkolla nuk është mjaftueshëm e ngrohtë gjatë dimrit dhe freskët gjatë verës.
- Ekziston mungesë e shkallëve të sigurisë dhe planit të emergjencës në shkollë.
- Ekziston mungesë e qasjes së sigurtë për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Nxënësit paguajnë nga xhepi i tyre për kompani private të sigurimit.
- Në shkollë ka mungesë të ujit, detergjentit për larjen e duarve dhe pecetave.
- Cilësia e ajrit dhe ndriçimi adekuat është shqetësues për nxënësit.
- Ka mungesë të psikologëve në shkollë.

Ligji për arsimin para-universitar (04/L-032), rregullon shumicën e çështjeve të lartpërmendura, por që rëndom gjejnë zbatim, për shkaqe të ndryshme, marrë parasysh të dhënat nga studime e analiza në këtë fushë (Mekolli, 2015, OSBE, 2018; Buçaj, 2018). Për më tepër, puna drejt përmirësimit të gjendjes në këto dimensione ka qenë dhe është vazhdimisht pjesë e strategjive kombëtare për cilësinë në arsim. Për të ilustruar, ndër objektivat e strategjisë afatgjate për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë (2009-2018), krijuar nga Komiteti Ndërministror, kanë qenë: mjedis i shëndetshëm dhe përkrahës nga ana e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve; përkujdesje cilësore dhe e vazhdueshme për shëndetin e nxënësve dhe mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënë.

Në këtë linjë, edhe strategjia e fundit për arsimin (2007-2017), ka specifikuar objektivat për të arritur kushte më të mira për të gjithë nxënësit. Kjo strategji udhëzon për sigurimin e kushteve të përfshatshme për përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e arsimit, gjithëpërfshirjen, barazinë, respektimin e diversitetit në arsim, integrimin e të gjitha komuniteteve etnike, krijimin e kushteve për aktivitete fizike dhe sportive, pajisje me mjete konkretizimi në shkolla dhe përdorim i tyre nga mësimdhënësit, e udhëzime në dimensione të tjera.

Përveç raportit të fundit nga KYC, edhe organizata e institucione tjera në vend kanë zhvilluar studime drejt matjes së dimensioneve të ndryshme të cilësisë në arsim. Marrë shembull, hulumtimi nga Mekolli (2015) për Institutin Pedagogjik të Kosovës, në hulumtimin për Dhunën dhe Sigurinë në Shkolla, gjeti se sulmet nga qentë endacakë, ngacmimet nga huliganët, aksidentet nga mjetet e komunikacionit janë arsyt kryesore të ndjenjës së pasigurisë në shkollë. Tutje, 60% e nxënësve kanë parë ndonjë nxënës që ka qenë viktimë e dhunës, kërcënimit apo ngacmimit në shkollë. Sa i përket higjienës, sipas raportit të ri-organizimit të shkollave të vitit 2019 në komunën e Kamenicës, 40% e shkollave të nivelit të ulët mësimor nuk kanë mjedis të pastër, specifikisht kanë tualete jo funksionale. Gjersa, me aq njohuri e hulumtim sa kemi bërë nuk ka ndonjë studim tjetër që mat nivelin e higjienës në shkolla. Në anën tjetër në aspektin e përmbajtjes dhe praktikave mësimore, sistemi i arsimit në Kosovë është kritikuar shumë si shkak i rezultateve të ulëta në garën për arsim PISA, duke u rendiur kështu në fund të listës për disa vite radhazi.

Kur flasim për shëndetin mendor dhe shkollat, përgjegjësitë e psikologëve dhe pedagogëve shkollorë janë të rregulluara sipas Udhëzimit Administrativ nr. 34/2014 për funksionimin e shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në Shkolla.

Sipas faqes zyrtare të Asocacionit të Psikologëve Shkollorë të Kosovës (APSHK), për 1058 institucione arsimore në Kosovë, janë të punësuar vetëm 57 psikologë shkollorë dhe 50 pedadogë. Pavarësisht faktit se roli i psikologëve është shumë i rëndësishëm, për shkak të lehtësimit të barrës të mësimave, menaxhimit të presionit social, të shqetësimeve mendore përgjatë viteve të adoleshencës, dinamikave që kjo fazë zhvillimore përmbandhe nevojës për përkrahje, numri i psikologëve shkollorë të punësuar është shumë i ulët.

Për të ilustruar, Arënlju dhe kolegët (2013), hulumtuan rreth mendimeve vetëvrasëse dhe kuptuan se janë prevalente ndër adoleshentët Kosovarë. Në anën tjetër, sipas Ukës dhe kolegëve (2021), zhvillimi i aseteve zhvillimore të jashtme, siç janë mbështetja nga të tjerët dhe fuqizimi i nxënësve, luan rol të rëndësishëm në arritjen e lartë akademike.

Përveç faktorëve të lartpërmendur, vështirësitë e edukimit në Kosovë përfshijnë edhe mungesën e infrastrukturës në shkollë, buxhetin për trajnimin e mësimitdhënësve, materiale adekuate të mësimitdhënies, mungesën e laboratorëve, numrin e lartë dhe/ose të ulët të nxënësve në shkolla (varësisht prej komunave), e shumë të tjera. Në këtë linjë, Kosova ka rrugë sfiduse drejt përmirësimit të cilësisë në arsim. Prandaj, Këshilli Rinor Kosovar me aktivitetet e tij angazhohet drejt lehtësimit të kësaj rruge, përmes iniciativave të ndryshme lidhur me avancimin në edukim, ndër të cilat është edhe ky raport hulumtues.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT AKTUAL

Duke pasur parasysh që Këshilli Rinor Kosovar (KYC) avokon që nxënësit të përfshihen si partnerë në përpjekjet për përmirësimin e cilësisë në arsim, një nga praktikrat më të mira për përfshirje në këtë qëllim është të kuptohen qëndrimet e nxënësve ndaj tij. Raporti aktual synon të vlerësojë cilësinë në arsim duke u bazuar në perceptimet e nxënësve për përmbajtjen, procesin dhe mjedisin mësimor. KYC, gjithashtu synon ta kthejë këtë qasje nga baza në traditë përmes raportimit për situatën aktuale dhe përfshirjes në procesin e vendimmarrjes me institucionet.

Raporti synon të kuptojë problemet dhe shqetësimet kryesore të nxënësve në dimensione të ndryshme, si literatura, lëndët me zgjedhje, vlerësimi dhe metodat e mësimdhënies, përmbushja e qëllimeve personale arsimore, laboratorët, zhurmat, siguria e shkollës, higjiena, ndriçimi, biblioteka, shëndeti mendor, pirja e duhanit, dhuna, ushqimi, gjithpërfshirja, përfshirja e prindërve/kujdestarit ligjor dhe aktivitetet jashtëshkollore.

Raportimi i individualizuar i secilës komunë duhet të ofrojë një pasqyrë më të detajuar të perceptimit të nxënësve në nivel lokal, duke ju ofruar komunave mundësinë që të orientojnë politikrat e tyre arsimore, duke u bazuar në të dhëna.

METODOLOGJIA

Ky hulumtim ka dizajn sasior pasi ka përdorur pyetësin si bazën kryesore të matjes së perceptimit të nxënësve për cilësinë në edukim, specifikisht tri dimensione të tij: përmbajtjen, procesin dhe mjedisin mësimor. Në kuadër të pyetësit nxënësit kanë pasur mundësinë të shprehin mendime, gjë që i ka shtuar edhe vlerë cilësore hulumtimit.

Mostrimi i rastësishëm i stratifikuar është përdorur për të mbledhur të dhënat. Kjo do të thotë se komunat janë konsideruar si grupe, dhe në bazë të numrit të nxënësve dhe shkollave në atë vend është bërë shtresimi i popullësisë, me qëllim të tentimit që të mos kemi mbipërfaqësim apo nënpërfaqësim të ndonjë komune. Në shtojcën II bashkëngjitur gjeni numrin e nxënësve të secilës komunë që përfundimisht kanë marrë pjesë në studim.

Për raportet e detajuara për secilën komunë janë mbledhur dhe analizuar të dhënat nga grupi i asaj komune.

MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Grumbullimi i të dhënave është bërë në periudhën shkurt-mars 2022, në formë fizike dhe virtuale. Në formën fizike, pyetësi është administruar nga nxënës/përfaqësues të Këshillit të Nxënësve të Kosovës (KNK), të cilët përmes telefonit në Google Form, kanë plotësuar pyetësin gjersa nxënësit e tjerë janë përgjigjur. Duke qenë se përfaqësuesit e Këshillit Drejtues (KD) përfaqësojnë komunën, ata kanë pasur përgjegjësi të monitorojnë përfaqësuesit e nxënësve nga shkollat e tjera në komunën e tyre; nxënës/e përgjegjës/e për mostrën nga një shkollë përkatëse.

Gjithsesi, për shkak të kufizimeve në shkollat ku ka pasur numër të madh të rasteve me Covid-19, në pak raste, grumbullimi i të dhënave është bërë edhe duke e ndarë pyetësin me nxënësit e shkollës sipas udhëzimeve të përshkruara më poshtë.

Para fillimit të administrimit, nxënësit përveç që kanë ndjekur një trajnim për administrim të pyetësit, ata kanë pranuar edhe një video e cila ka shpjeguar hapat që duhet ndjekur për t'iu qasur nxënësve dhe si të elaborojnë pyetjet në rast të ndonjë paqartësie. Gjithashtu, secilit/es administrues/e iu është dërguar numri i mostrës që është i nevojshëm për shkollë dhe komunë. Me qëllim të një mostre me diversitet, administruesit janë udhëzuar gjithashtu që në mostrën e shkollës përkatëse të intervistojnë duke pasur parasysh balancin në gjini, etni, sukses akademik dhe aftësi të kufizuar.

KRIJIMI I INSTRUMENTIT MATËS

Formulimi i pyetësit për matjen e perceptimit të nxënësve mbi cilësinë në arsim ka kaluar gjithsej tri faza për t'u finalizuar. Faza e parë ka përfshirë nxjerrjen e dimensioneve kryesore nga të gjeturat e raportit mbi cilësinë në arsim, në publikuar nga KYC në vitin 2016, dhe formulimin e deklaratave dhe pyetjeve në këto të gjetura.

Faza e dytë ka përfshirë marrjen e komenteve nga nxënësit e Këshillit Drejtues të Nxënësve. Këta të fundit janë ndarë në grupe dhe kanë ofruar propozime për ndryshime ose shtesa në pyetësor. Në fazën e tretë, janë marrë parasysh komentet, është ristrukturuar pyetësi dhe është bërë konsultimi përsëri me stafin e KYC.

INSTRUMENTI MATËS

Pyetësi gjithsej ka pasur 90 pyetje, dhe ka marrë kohë rreth 30 minuta për t'u administruar. Pyetësi ka përfshirë pyetjet demografike (klasa, gjinia, orientimi seksual, etnia, vendbanimi, nevoja e veçantë) dhe pyetje tjera të ndara në 22 dimensione tjera të ndërlidhura me cilësinë në arsim, specifiku për përmbajtjen, procesin dhe mjedisin mësimor. Në tabelen nr.1 gjeni të gjitha dimensionet me pyetjet model për dimensionet që janë trajtuar në kuadër të pyetësorit në fjalë. Tutje, pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të ofrojnë komente shtesë rreth temave dhe/ose pyetësorit.

ASPEKTI ETIK

Dizajni i hulumtimit dhe realizimi i tij është bërë në përputhje me parimet etike për studime, Nxënësve iu është garantuar besueshmëri e plotë e të dhënave dhe iu është bërë e ditur se mund të largohen nga plotësimi i pyetësorit në rast se nuk ndihen mirë fizikisht, psikikisht apo nëse për ndonjë arsye tjetër vendosin të mos marrin pjesë. Tutje, nuk është marrë në asnjë rast emri ose ndonjë e dhënë tjetër identifikuese.

ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e mbledhura në Google Form, janë bartur në Excel, ku është bërë pastrimi i databazës. Tutje, të dhënat janë koduar në Paketën Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS). Rezultatet, interpretimet dhe diskutimi janë bërë në varësi prej të dhënave të fituara nga pjesëmarrësit.

Nr.	Dimensionet	Pyetje model
1	Përmbajtja e librave	“Unë kam vërejtur se tekstet e librave përmbajnë gabime drejtshkrimore”
2	Përdorimi i librave	“Ne përdorim libra për çdo lëndë mësimore”
3	Notimi	“Unë jam notuar në një lëndë në bazë të notave në lëndë të tjera”
4	Praktikat e ligjërimit	“Mësimdhënësit ndajnë klasën në grupe për të punuar për detyra/projekte”
5	Qëllimet personale të edukimit	“Unë mendoj se mësimet në shkollë i kontribuojnë qëllimeve të mia afatgjate në edukim”
6	Higjiena	“Në klasë ka numër të madh të mbeturinave”
7	Ndriçimi dhe klima	“Në shkollë dhe në klasa ka mjaftushëm ndriçim”
8	Pirja e duhanit në shkollë	“Nxënësit pijnë duhan në ambientet e brendshme të shkollës”
9	Perceptimi i sigurisë në shkollë	“Rrugës për në shkollë dhe rreth saj ne rrezikohemi nga qentë endacakë”
10	Dhuna nga mësimdhënësit	“Në shkollë ka mësimdhënëës që godasin nxënësit”
11	Dhuna në mes të nxënësve	“Në shkollë nxënësit grinden fizikisht me njëri-tjetrin”
12	Përfshirja e prindërve në shkollë	“Prindërit/kujdestarët janë zë i rëndësishëm në vendimet e shkollës”
13	Lënda zgjedhore	“Unë kam pasur mundësinë të zgjedh lëndën zgjedhore”
14	Laboraret	“Në shkollën time është funksional...”
15	Biblioteka	“Ne kemi bibliotekë në shkollë”
15.1.	Biblioteka	“Biblioteka në shkollë është e qasshme për të mësuar pas mësimit.”
16	Zhurma	“Zhurma përreth objektit të shkollës dëmton procesin mësimor në klasë”
17	Trafiku afër shkollës	“Afër shkollës ka vija të bardha për kalim të sigurt të rrugës”
18	Shëndeti mendor	“Në shkollë ka psikolog/e të punësuar”
19	Ushqimi	“Kemi bufe në shkollë”
20	Gjithëpërfshirja	“Në shkollë ka pjerrinë për qasje në shkollë për nxënësit ose mësimdhënësit me aftësi të kufizuara”

REZZ

TAT

ZUL


RET

REZULTATET SASIORE


Fillimisht, të dhënat janë analizuar në mënyrë deskriptive me qëllim për të kuptuar gjendjen aktuale.

Në Prizren, morën pjesë në pyetësor gjithsej 129 pjesëmarrës. 19,4% (N=25) janë në klasën e dhjetë, 31% (N=40) në klasën e njëmbëdhjetë dhe 49,6% (N=64) në klasën e 12-të. Nga ky numër i përgjithshëm, 28,7% (N=37) jetojnë në fshat ndërsa 71,3% (N=92) në qytet. 97,7% (N=126) e nxënësve në këtë pyetësor janë shqiptarë, 0,8% (N=1) romë, 0,8% (N=1) ashkali dhe 0,8% (N=1) boshnjakë. Sa i përket statistikave të tjera demografike, 69,8% (N=90) e nxënësve ishin femra dhe 30,2% (N=39) meshkuj. Në këtë linjë, 74,4% (N=96) prej tyre raportuan se ishin heteroseksualë, 0,8% (N=1) u përgjigjën se ishin homoseksualë, 0,8% (N=1) deklaruan orientimin e tyre seksual si 'tjetër'. dhe 24% (N=31) e studentëve preferuan të mos i përgjigjen pyetjes. Një sasi e konsiderueshme prej 9,3% (N=12) raportuan se kishin nevoja të veçanta, kurse 90,7% (N=117) nuk kishin nevoja të veçanta.


Klasa




Vendbanimi




Etnia




Gjinia



Orientimi seksual




Nevoja e vecante




Kur flasim rreth materialit mësimor, duke marrë parasysh gjetjet e raportit të përgjithshëm “Cilësia në Arsim”, nuk është për t'u habitur që 28,7% e nxënësve e kanë deklaruar si shumë të vërtetë që ka gabime drejtshkrimore në librat e tyre. Për të njëjtin pohim 51,9% e menduan këtë si pjesërisht të vërtetë, 6,2% pjesërisht të pavërtetë, 2,3% shumë të pavërtetë ndërsa 10,9% nuk e dinin nëse kishte apo jo gabime drejtshkrimore në librat e tyre. Për sa i përket saktësisë së informacionit në librat shkollorë, 4,7% e nxënësve e deklaruan si shumë të vërtetë se në librat e tyre ka gabime faktike, 32,6% e konsiderojnë këtë si pjesërisht të vërtetë, 20,2% pjesërisht të pavërtetë, 19,4% shumë të pavërtetë dhe 23,3% nuk kanë vërejtur nëse ka gabime faktike në librat e tyre shkollorë. Një çështje tjetër e rëndësishme në të cilën KYC dëshironte të fokusohet është përditësimi i informacionit në këto libra shkollorë, ku 44,2% e nxënësve në këtë hulumtim e kanë konsideruar si shumë të vërtetë që librat e tyre janë të përditësuar, 37,2% e konsideruan këtë si pjesërisht të vërtetë, 3,1% e menduan si pjesërisht të pavërtetë, 5,4% shumë të pavërtetë dhe 10,1% e nxënësve nuk e vunë re nëse librat ishin të përditësuar për nga aspekti i informacionit apo jo.


Unë kam vërejtur se tekstet e librave përmbajnë gabime faktike



Unë kam vërejtur se tekstet e librave përmbajnë gabime drejtshkrimore




Unë kam vërejtur se tekstet e librave nuk janë të ri-freskuar me informata të reja




Në të njëjtin varg temash, një pikë tjetër që ia vlen t'i kushtohet vëmendje në lidhje me shumëllojshmërinë e materialit mësimor është se 43,4% e nxënësve e mendojnë si shumë të vërtetë pohimin që kanë libra për çdo lëndë, 34,1% e menduan këtë si pjesërisht të vërtetë, 13,2% si pjesërisht të pavërtetë dhe 9,3% e deklaruan si shumë të pavërtetë. Në lidhje me materialet mësimore jashtë programit edukativ, 13,2% e konsiderojnë si shumë të vërtetë që përdorin skripta në klasë, 55,8% e konsiderojnë si pjesërisht të vërtetë, 14,7% pjesërisht të pavërtetë dhe 16,3% deklaruan se është shumë e pavërtetë që përdorin skripta në klasë. Përveç skriptave, 7,8% e shohin si shumë të vërtetë që përdorin libra që nuk janë pjesë e kurrikulës. 24% e shohin këtë si pjesërisht të vërtetë, 11,6% pjesërisht të pavërtetë dhe 56,6% e nxënësve e shohin si shumë të pavërtetë që përdorin libra që nuk janë pjesë të kurrikulës në orët e tyre në klasë.


Ne përdorim libra për cdo lëndë mësimore




Ne përdorim skripta për të mësuar lëndët



Ne përdorim libra të cilat nuk janë pjesë e kurrikulës




Neve na u është diktuar mësimi të paktën njëherë nga mësimmhënësit ose nga dikush që ata kanë përcaktuar




Një çështje që prek drejtpërsëdrejti nxënësit gjatë studimeve të tyre është sistemi i notimit i cili është gjithashtu një shqetësim i vazhdueshëm i këtyre nxënësve në diskutimet formale dhe joformale me ta. Sa i përket kësaj fushe, 27,9% e nxënësve kanë deklaruar se nuk janë vlerësuar asnjëherë në bazë të një burimi të vetëm ndërsa 27,9% deklaruan se kjo u ndodh ndonjëherë. Përkundrazi, 29,5% thanë se kjo ka ndodhur shpesh dhe 14,7% thonë se gjithmonë janë vlerësuar në bazë të një burimi të vetëm. Kjo në vetvete është problematike duke pasur parasysh se është e detyrueshme që nxënësit të vlerësohen në bazë të burimeve të shumta në mënyrë që të portretizohet një vlerësim të vërtetë i njohurive të tyre. Në një pikë të të ngjashme, 62,8% e nxënësve thanë se nuk janë vlerësuar kurrë në bazë të sjelljes së tyre, ndërsa 20,2% thonë se kjo u ndodh ndonjëherë. Poashtu, 11,6% thonë se kjo ndodh shpesh dhe 5,4% thonë se vlerësohen gjithmonë në bazë të sjelljes së tyre. Kjo është gjithashtu problematike duke pasur parasysh se ekziston një sistem i veçantë notimi për të vlerësuar sjelljen e nxënësve që nuk duhet të ndikojë në sistemin e notimit për njohuritë dhe lëndët. Një gjetje befasuese doli kur identifikua nxënësit që vlerësoheshin në mungesë të tyre, ku 62% thonë se nuk janë vlerësuar kurrë në mungesë, 17,1% thonë se ndonjëherë janë vlerësuar në mungesë, 12,4 % thonë se kjo ndodh shpesh dhe 8,5% e nxënësve thonë se janë vlerësuar gjithmonë në mungesë. Një gjetje shqetësuese është se 36,4% e nxënësve thonë se nuk janë vlerësuar kurrë në bazë të notave nga lëndët e tjera, 24,8% thonë se ndonjëherë janë vlerësuar në bazë të notave të tjera dhe 26,4% thonë se ata shpesh vlerësoheshin në bazë të notave nga lëndët e tjera, ndërsa 12,4% e nxënësve raportuan se vlerësoheshin gjithmonë në bazë të notave nga lëndët e tjera. Kjo ndikon në objektivitetin në sistemin e notimit, gjë që çon në një paraqitje të rreme të njohurive dhe aftësive të nxënësve gjatë studimeve të tyre.


Unë kam marrë notë duke u vlerësuar vetëm nga një burim (me gojë, shkrim ose aktivitet) dhe jo kombinim




Unë kam marrë notë vetëm në bazë të sjelljes sime gjatë orës së mësimi dhe jo dijes



Unë jam notuar pa prezencën time




Unë jam notuar në një lëndë në bazë të notave në lëndë të tjera




Duke kaluar te metodat e mësimdhënies, 16,3% e nxënësve raportuan se metodat e mësimdhënies të përdorura nga mësuesit nuk janë kurrë të mërzitshme, ndërsa 28,7% thonë se metodat ndonjëherë janë të mërzitshme. Në anën e kundërt 36,4% deklaruan se metodat e mësimdhënies janë shpesh të mërzitshme, kurse 18,6% thonë se janë gjithmonë të tilla. Një faktor i rëndësishëm për një mësimdhënie efektive janë metodat e përditësuara të përdorura për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve. Në këtë aspekt 19,4% thonë se mësimdhënësit nuk përdorin kurrë video në klasë, 33,3% thonë se ata ndonjëherë përdorin video, 34,9% thonë se përdorin shpesh dhe 12,4% deklaruan se mësimdhënësit përdorin gjithmonë video në klasë. Përdorimi i instrumenteve dhe mjeteve konkretizuese është padyshim një vlerë e shtuar në mësimdhënien efektive, ku në atë fushë 12,4% e nxënësve thonë se mësimdhënësit nuk përdorin asnjëherë mjetet e duhura konkretizuese për mësimdhënie, 34,1% thonë se ata ndonjëherë i përdorin, 30,2% thonë se shpesh është kështu dhe 23,3% e nxënësve thonë se mësimdhënësit përdorin gjithmonë mjete konkretizuese për mësimdhënie. Mbi të gjitha metodat e mëposhtme, një faktor i rëndësishëm është edhe interaktiviteti në klasë i cili promovon gjithëpërfshirjen dhe angazhimin e nxënësve. Në lidhje me këtë çështje, 10,1% deklaruan se mësimdhënësit nuk i kushtojnë kurrë vëmendje interaktivitetit në klasë, 28,7% thonë se ata ndonjëherë i kushtojnë vëmendje, 41,1% thonë se i kushtojnë rëndësi shpesh dhe 20,2% deklaruan se mësimdhënësit gjithmonë i kushtojnë vëmendje interaktivitetit. Vlen gjithashtu të përmendet se 34,1% thonë se mësimdhënësit nuk ndajnë kurrë informacione personale gjatë mësimdhënies, 36,4% thonë se kjo ndodh ndonjëherë, 20,9% thonë se ndodh shpesh dhe 8,5% e nxënësve thonë se mësimdhënësit gjithmonë ndajnë informacione personale në klasë.


Unë mendoj se mënyra e ligjërimit të lëndëve në shumicën e rasteve është e mërzitshme (boring).




Mësimdhënësit gjatë ligjërimit shpesh përdorin video për të ilustruar më mirë mësimin.




Mësimdhënësit përdorin mjete konkretizuese për spjegimin e lëndës






Mësimdhënësit i kushtojnë rëndësi interaktivitetit përmes diskutimeve.




Mësimdhënësit kalojnë më shumë se gjysmën e orës duke ndarë informata personale dhe jo-relevante me temën.




Sa i përket burimeve të tjera mësimore dhe përfshirjes së përgjithshme të mësimdhënësve gjatë orës mësimore, 16,3% e nxënësve thanë se është shumë e pavërtetë që mësimdhënësit shpërndajnë vetëm shënime në klasë. 53,5% e nxënësve thonë se kjo është pjesërisht e pavërtetë, ndërsa 21,7% kanë deklaruar se kjo është pjesërisht e vërtetë dhe 8,5% kanë gjetur se është shumë e vërtetë. Në atë zingjir mendimesh 10,9% e shohin si shumë të pavërtetë që mësimdhënësit shpesh i ndajnë klasat në grupe. Ky nuk është gjithmonë rasti pasi që 34,9% e nxënësve nën këtë hulumtim e shohin këtë si pjesërisht të pavërtetë, 38% pjesërisht të vërtetë dhe 16,3% shumë të vërtetë. Një tjetër temë dhe çështje problematike është fluksi i kurseve private që mbahen nga mësimdhënësit e shkollave për të njëjtën lëndë, ku 43,4% deklaruan se ishte shumë e pavërtetë që mësimdhënësit ofrojnë kurse private për lëndët që japin në shkollë, megjithëse 24,8% e panë këtë si pjesërisht të pavërtetë, 11,6% pjesërisht të vërtetë dhe 20,2% e nxënësve e panë si shumë të vërtetë që mësimdhënësit e tyre ofrojnë kurse private, gjë e cila është shumë problematike pasi që nuk është e vështirë të shihet se si kjo mund të ndikojë në notimin e nxënësve dhe ta largojë vlerësimin objektiv.

Mësimdhënësit japin vetëm shënime

Mësimdhënësit ndajnë klasën në grupe për të punuar në detyra/projekte

Ne kemi mësimdhënës të cilët mbajnë kurse private për lëndën që ligjërojnë në shkollë.



Në frytshmërinë e perceptuar të mësimëve nxënësit kanë dhënë disa pohime shumë pozitive që mund të shihen më poshtë, ku vetëm 3,1% e nxënësve e konsiderojnë si shumë të pavërtetë dhe 15,5% pjesërisht të pavërtetë që orët mësimore në shkollë do t'i ndihmojnë ata të arrijnë qëllimet e tyre afatgjata arsimore. Nga ana tjetër, 52,7% e konsideruan këtë si pjesërisht të vërtetë dhe 28,7% shumë të vërtetë. Në një pikë të ngjashme, 3,1% deklaruan se është e pavërtetë që mësimet në shkollë janë të dobishme në jetën e tyre në përgjithësi, ndërsa 10,1% e konsideruan këtë si pjesërisht të pavërtetë, 37,2% pjesërisht të vërtetë dhe 49,6% si shumë të vërtetë që orët në shkollë janë të dobishme në këtë drejtim. Për më tepër, 6,2% mendojnë se është shumë e pavërtetë që mësimet në shkollë i ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve jashtë shkollës, ndërsa 19,4% e mendojnë këtë si pjesërisht të pavërtetë, 41,1% pjesërisht të vërtetë dhe 33,3% e nxënësve e mendojnë si shumë të vërtetë që orët në shkollë janë të dobishme për zgjidhjen e problemeve jashtë shkollës. Një konstatim tjetër shqetësues është se 15,5% e shohin si shumë të pavërtetë se janë përgatitur për tregun e punës në bazë të mësimëve në shkollë. 21,7% e konsiderojnë këtë pjesërisht të pavërtetë, 35,7% pjesërisht të vërtetë dhe 27,1% e konsiderojnë shumë të vërtetë që janë të përgatitur mirë për tregun e punës nga shkolla e tyre.

Unë mendoj se mësimet në shkollë i kontribuojnë qëllimeve të mija afatgjata në edukim.



Unë mendoj se mësimet në shkollë janë të dobishme.




Unë mendoj se mësimet në shkollë më ofrojnë mundësi të zgjedh probleme në të ardhmen.



Unë mendoj se programi i shkollës më ka përgaditur shumë për tregun e punës




Unë kam pasur mundësinë të zgjedh lëndën zgjedhore




Kur diskutohet më shumë për aspektet strukturore brenda këtyre institucioneve arsimore, 74,4% e nxënësve thonë se kanë bibliotekë në shkollën e tyre ndërsa 25,6% thonë se nuk kanë. Nga ata që thonë se ka një bibliotekë, 36,5% thonë se ka një bibliotekar që e mban këtë hapësirë ndërsa 63,5% thonë se nuk ka asnjë. Nga ana tjetër, kur diskutohet për kushtet e bibliotekave në fjalë, 14,6% thonë se është shumë e pavërtetë që ka një sasi të mjaftueshme librash në bibliotekë, 25% thonë se është pjesërisht e pavërtetë, 36,5% thonë se është pjesërisht e vërtetë dhe 24% thonë se është shumë e vërtetë. Opinione për orarin e punës në këto hapësira ndryshojnë ku 45,8% e nxënësve thonë se është shumë e pavërtetë që biblioteka është e hapur për mësim jashtë orarit të rregullt shkollor, 21,9% e thonë se kjo është pjesërisht e pavërtetë, 19,8% thonë se është pjesërisht e vërtetë dhe 12,5% thonë se është shumë e vërtetë që mund të studiojnë në bibliotekë jashtë orarit të rregullt shkollor. Deklarata të përziera mund të gjenden në pikën tjetër ku 20% e konsiderojnë si shumë të pavërtetë që librat në bibliotekë përputhen me mësimet në klasë, ndërsa 24,4% e konsiderojnë këtë pjesërisht të pavërtetë, 42,2 % e konsiderojnë atë pjesërisht të vërtetë dhe 18,8% e nxënësve thonë se është shumë e vërtetë që librat në bibliotekë përputhen me mësimet në klasë.


Ne kemi bibliotekë në shkollë




Biblioteka ka bibliotekist/e




Biblioteka në shkollë ka numër të mjaftueshëm të librave



Biblioteka në shkollë është e qasshme për të mësuar pas mësimit.




Librat në bibliotekë përkojnë me mësimet/moshën/nivelin tonë akademik




Sa i përket zhurmës dhe shqetësimeve në shkollë, 15,5% e nxënësve thonë se nuk ka asnjëherë zhurmë shqetësuese rreth ndërtesës së shkollës që ndërhyr në procesin mësimor. Kjo nuk është gjithmonë e vërtetë kur 35,7% e nxënësve deklaruan se ka ndonjëherë zhurmë që ndërhyr në procesin mësimor, 24,8% thonë se kjo shpesh ndodh dhe 24% që deklaruan se kjo ndodh gjithmonë. Në temën se si trajtohet kjo zhurmë nga mësimitdhënësit, 28,7% deklaruan se mësimitdhënësit nuk dështojnë kurrë në menaxhimin e zhurmës në klasë, ndërsa 32,6% deklaruan se mësimitdhënësit vetëm ndonjëherë arrijnë ta menaxhojnë zhurmën dhe 31% thonë se mësimitdhënësit shpesh dështojnë në menaxhimin e zhurmës, ndërsa 7,8% e nxënësve thonë se mësimitdhënësit gjithmonë dështojnë në menaxhimin e zhurmës në klasë. Duke u ndërlidhur me pikën e fundit për të identifikuar zhurmën që shkaktohet nga vetë mësimitdhënësit, 51,2% thonë se mësimitdhënësit nuk janë asnjëherë shkaktarë të zhurmës, 31% thonë se ata ndonjëherë janë ndërsa 13,2% thonë mësimitdhënësit shpesh janë shkaktarë dhe 4,7% që deklarojnë se mësimitdhënësit janë gjithmonë shkak i zhurmës në klasë. Kur diskutohet për zhurmën e shkakuar nga faktorë të ndryshëm që ndërhyjnë në procesin e mësimitdhënies, nuk mund të shmangim zhurmën dhe shqetësimet e shkaktuara nga vetë nxënësit, ku 6,2% e nxënësve thonë se nxënësit nuk janë asnjëherë shkak i zhurmës në klasë, 11,6% thonë se ata ndonjëherë janë, 45% thonë se nxënësit shpesh janë shkak i zhurmës në klasë dhe 37,2% e nxënësve thonë se nxënësit janë gjithmonë shkak i zhurmës në klasë.


Zhurma rreth objektit të shkollës dëmton procesin mësimor në klasa




Mësimdhënësit nuk arrijnë të menaxhojnë zhurmën në klasë



Mësimdhënësit janë shkaktarë të zhurmës në klasë




Nxënësit janë shkaktarë të zhurmës në klasë




Duke u thelluar në temën e çështjeve infrastrukturore dhe duke vazhduar me sigurinë në komunikacion gjatë rrugës për në shkollë, 36,4% thonë se ka pengesa shpejtësie rreth shkollës ndërsa 63,6% e nxënësve thonë nuk ka asnjë. Në rrjedhë të ngjashme 46,5% thonë se ka vendkalime për këmbësorë, por 53,5% thonë se nuk është kështu. Një faktor i shtuar që vlen të përmendet është se 69,8% e nxënësve thonë se ka shumë makina që kalojnë shpejt afër shkollës së tyre, ndërsa 30,2% thonë se nuk është kështu.


Afër shkollës ka policë të shtrirë (pengesa për qëllim të ngadalsimit të shpejtësisë)



Afër shkollës ka vija të bardha për kalim të sigurt të rrugës




Afër shkollës kalojnë veturat me shpejtësi të lartë që rrezikojnë mirëqenien tonë




Çështje të tjera infrastrukturore në vetë ndërtesën e shkollës janë po ashtu shqetësuese. Sipas 11,6% të nxënësve është e vërtetë që kanë ujë të ngrohtë në banjo, por ky nuk është rasti me 88,4% që thonë se kjo nuk është e vërtetë. Një tendencë e ngjashme mund të shihet edhe në çështje të tjera, siç janë pecetat e banjos, ku 7,8% thonë se është e vërtetë që kanë peceta në banjo dhe 92,2% e nxënësve thonë se kjo nuk është e vërtetë. Një statistikë e rëndësishme është vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së banjove të shkollave ku 40,3% thonë se është e vërtetë që banjot janë higjienike ndërsa 59,7% thonë se nuk është kështu. Në atë linjë diskutimi, 25,6% e nxënësve thonë se nuk ka kurrë erë të pakëndshme në ambientet shkollorë, 27,1% thonë se ndonjëherë ka, 21,7% thonë se shpesh ka dhe 25,6% të tjerë të nxënësve thonë se gjithmonë ka një erë të pakëndshme në këto ambiente. Cilësia e ajrit është një metrikë që ka pasur vend në këtë hulumtim, ku 18,6% e nxënësve thonë se ajri është gjithmonë i ndotur, 38% thonë se është i pastër herë pas here, 26,4% e nxënësve thonë se ajri është shpesh i pastër dhe 17,1% thonë se ajri është gjithmonë i pastër.


Në banjot e shkollës ka uje te ngrohtë




Në banjot e shkollës ka peceta




Në banjot e shkollës ka detergjent për larjen e duarve



Në shkollë vie një erë jo e këndshme




Në shkollë ajri është i pastër




Duke u kaluar nga aspektet strukturore të objektit shkollor drejt mirëmbajtjes së përgjithshme të tij, 55% e nxënësve thonë se muret e shkollës nuk janë asnjëherë të lagështa. Në anën tjetër, 24% thonë se muret nganjëherë janë të lagështa dhe me myshk, ndërsa 7% thonë se muret janë shpesh në këtë gjendje dhe 14% thonë se muret janë gjithmonë të lagështa dhe me myshk. Sa i përket gjendjes së mbeturinave në këto ambiente, 45% e nxënësve thonë se nuk ka asnjëherë një sasi të madhe mbeturinash në shkollën e tyre, por kjo nuk është gjithmonë rasti për pjesën tjetër të të anketuarve, ku 34,9% thonë se ndonjëherë ka sasi të mëdha të mbeturinave në shkollë, 8,5% thonë se ka shpesh dhe 11,6% thonë se gjithmonë ka sasi të mëdha të mbeturinave në shkollë. Kur diskutohet për mirëmbajtjen e shkollës, 7% thonë se mirëmbajtja nuk bëhet kurrë nga nxënësit, 20,2% thonë se mirëmbajtja ndonjëherë bëhet nga nxënësit ndërsa 30,2% thonë se kjo ndodh shpesh dhe 42,6% thonë se mirëmbajtja bëhet gjithmonë nga nxënësit. Kjo është shqetësuese pasi që duhet të ketë staf përgjegjës në këtë fushë, duke konsideruar se lënia e mirëmbajtjes në dorë të nxënësve i lë këto hapësira të pakujdesura. Në rastet kur ka punëtorë mirëmbajtjeje, 6,2% e nxënësve thonë se këta punëtorë të mirëmbajtjes nuk e bëjnë kurrë punën e duhur, 15,5% thonë se punëtorët e mirëmbajtjes ndonjëherë bëjnë një punë të duhur, 37,2% thonë se shpesh bëjnë një punë të duhur dhe 41,1% thonë se punëtorët e mirëmbajtjes bëjnë gjithmonë një punë të duhur sa i përket mirëmbajtjes së shkollës. 10,1% e nxënësve thonë se banjot e mësimdhënësve nuk janë asnjëherë më të pajisura se banjot e nxënësve, ndërsa 22,5% thonë se ndonjëherë është kështu. Në anën e kundërt, 16,3% thonë se banjot e mësimdhënësve janë shpesh më të pajisura dhe 51,2% e nxënësve thonë se banjot e mësimdhënësve janë gjithmonë më të pajisura se banjot e nxënësve.


Ka lagështi në klasë tek muret (myk)




Në klasë ka numër të madh të mbeturinave




Nxënësit mirëmbajnë klasën (gjuajnë mbeturinat në shportë)



Mirëmbajtësit në shkollë kryejnë punën ashtu siç duhet




Banjot e mësimdhënësve janë më të pastërta dhe pajisura se të nxënësve




Duke qenë se ndërtesat supozohet të mbrojnë banorët e tyre nga faktorët e jashtëm dhe të ofrojnë një mjedis të qëndrueshëm pavarësisht ndryshimeve mjedisore gjatë stinëve, pyetësi trajtoi gjithashtu aftësinë e objekteve shkollore për të bërë pikërisht këtë. 5,4% e nxënësve e konsiderojnë si shumë të pavërtetë që klasa ka ndriçim të duhur, 8,5% e konsiderojnë këtë pohim pjesërisht të pavërtetë ndërsa nga ana tjetër 36,4% e shohin këtë si pjesërisht të vërtetë dhe 49,6% shumë të vërtetë që klasa ka ndriçim të mjaftueshëm. Në këtë rrjedhë, 11,6% e konsiderojnë shumë të pavërtetë dhe 12,4% pjesërisht të pavërtetë që shkolla ishte mjaftueshëm e ngrohtë në dimër. Pikëpamje të ndryshme paraqesin 39,5% e nxënësve që mendojnë se kjo ishte pjesërisht e vërtetë dhe 36,4% që thonë se kjo ishte shumë e vërtetë. Për më tepër, 17,1% e konsiderojnë shumë të pavërtetë pohimin se shkolla në përgjithësi nuk është shumë e nxehtë. 25,6% e konsiderojnë këtë pjesërisht të pavërtetë, 31,8% pjesërisht të vërtetë dhe 25,6% e nxënësve e konsiderojnë shumë të vërtetë që shkolla në përgjithësi nuk është shumë e nxehtë. Një temë shqetësuese që është trajtuar edhe në këtë pyetësor është lidhur me duhan pirjen e nxënësve ku 23,3% e nxënësve kanë deklaruar se nxënësit nuk pinë duhan në shkollë, 12,4% kanë thënë se kjo ndodh ndonjëherë, 13,2% thonë se ndodh herë pas here, 10,1% thonë se ndodh shpesh dhe 41,1% thonë se nxënësit gjithmonë pinë duhan në shkollë. E njëjta dukuri është trajtuar edhe për mësimdhënësit, ku 48,1% e nxënësve thonë se mësimdhënësit nuk pinë duhan në shkollë, 11,6% thonë se ndonjëherë pinë, 14% thonë se pinë herë pas here, 5,4% thonë se pinë duhan shpesh dhe 20,9% thonë se mësimdhënësit gjithmonë pinë duhan në shkollë. Kjo mund të shkaktojë një efekt zinxhir pasi mund të ndikojë në normalizimin e kësaj shprehije negative. Përveç kësaj, sipas 54,3% e nxënësve, punëtorët e mirëmbajtjes nuk pinë kurrë duhan në shkollë, 12,4% thonë se ndonjëherë e pinë, 9,3% thonë se pinë herë pas here. Gjithashtu, 6,2% e nxënësve thonë se punëtorët e mirëmbajtjes e punë duhanin shpesh dhe 17,8% thonë se ata e pinë gjithmonë.


Në shkollë dhe në klasa ka mjaftueshëm ndriçim




Në shkollë është ngrohtë mjaftueshëm dimrit




Në shkollë është freskët mjaftueshëm verës




Nxënstit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës



Mësimdhënësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës




Punëtorët teknikë & mirëmbajtësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës




Duke vazhduar drejt nevojave të objekteve shkollore 15,5% e nxënësve e shohin shumë të pavërtetë që tavolinat dhe karriget janë në gjendje të mirë. 14,7% e konsiderojnë atë pjesërisht të pavërtetë, 59,7% e konsiderojnë atë pjesërisht të vërtetë dhe 10,1% e konsiderojnë shumë të vërtetë që tavolinat dhe karriget janë në gjendje të mirë për nxënësit për të mësuar. Në një pikë tjetër, 29,5% thonë se shkolla e tyre ka dalje emergjente dhe 70,5% e nxënësve thonë se shkolla e tyre nuk ka asnjë dalje të tillë, por gjithashtu 92,2% thonë se shkolla e tyre ka rrethoja dhe 7,8% thonë se kjo nuk është e vërtetë për shkollën e tyre. Duke vazhduar në fushën sigurisë së përgjithshme, 79,8% thonë se ka roje të sigurimit në shkollën e tyre ndërsa 20,2% thonë se nuk ka asnjë. Nga ata që thonë se kanë, 92,2% thanë se duhet t'i paguajnë rojet vetë ndërsa 7,8% thonë se nuk kanë nevojë ti paguajnë vetë.


Bankat, karriget dhe dyert në shkollë janë në gjendje të rregullt




Në shkollë ka shkallë emergjente funksionale




Shkolla ime është e rrethuar (ka rrethojë)



Ne kemi roje sigurimi në shkollë







Qëllim i çdo institucioni që merret me të rinjtë duhet të jetë t'i mbajë ata të sigurtë në mjedisin që ata ofrojnë. Në lidhje me këtë është befasuese që vetëm 24,8% e nxënësve thonë se është shumë e vërtetë që shkolla e tyre është e sigurt nga tërmetet, ndërsa 38,8% thonë se është pjesërisht e vërtetë, 20,2% thonë se është pjesërisht e pavërtetë dhe 16,3% mendojnë se është shumë e pavërtetë që shkolla e tyre do të ishte e sigurt në rast tërmeti. Një gjetje tjetër shqetësuese është se 22,5% e nxënësve e shohin shumë të vërtetë që nxënës nga shkollat e tjera mund të hyjnë në ambientet e tyre shkollore, 21,7% e shohin si pjesërisht të vërtetë, 23,3% pjesërisht të pavërtetë dhe 32,6% mendojnë se është shumë e pavërtetë që nxënësit nga shkollat e tjera mund të hyjnë në shkollën e tyre. Sa i përket kontrollit policor në shkolla, 8,5% e nxënësve e shohin shumë të vërtetë që policia bën kontrolle në shkollën e tyre, 18,6% e mendojnë si pjesërisht të vërtetë, 17,8% pjesërisht të pavërtetë dhe 55% mendojnë se është shumë e pavërtetë që policia bën kontrolle. Duke u ndalur në fenomenet që ndikojnë negativisht tek nxënësit, 20,2% e nxënësve në këtë hulumtim thonë se është shumë e vërtetë që kanë qasje në substanca narkotike në shkollë. Kjo është e diskutueshme në raste të tjera, ku 24,8% thonë se kjo është pjesërisht e vërtetë, 26,4% thonë se është pjesërisht e pavërtetë dhe 28,7% thonë se është shumë e pavërtetë. Një tjetër çështje mjaft e pranishme që është diskutuar është problemi i qenve endacakë pranë këtyre objekteve shkollore, ku 35,7% thonë se është shumë e vërtetë që qentë endacakë sillen rreth shkollës, 28,7% thonë se kjo është pjesërisht e vërtetë ndërsa 22,5% thonë se është pjesërisht e pavërtetë dhe 13,2% thonë se është shumë e pavërtetë. Një pikë fokusi në këto gjetje është ajo e ardhshme, ku 57,4% e nxënësve thonë se nuk kanë mësimdhënës që godasin nxënësit ndërsa 34,9% thonë se kanë mësimdhënës që godasin nxënësit. Për të njejtën çështje 6,2% e nxënësve thonë se shumë mësimdhënës e bëjnë këtë dhe 1,6% thonë se të gjithë mësimdhënësit godasin nxënësit. Kur trajtohen forma të ndryshme të abuzimit të pranishme në shkolla, është e rëndësishme të identifikohen numri i nxënësve që përballen ose janë dëshmitarë të ngacmimeve seksuale në mjediset e shkollës. Për këtë çështje, 72,9% thonë se nuk kanë mësimdhënës që ngacmojnë seksualisht nxënësit, por 17,8% thonë se ka pak mësimdhënës që e bëjnë këtë, 5,4% thonë se disa mësimdhënës që ngacmojnë seksualisht dhe 3,9% që thonë se shumë mësimdhënës ngacmojnë seksualisht.

Për më tepër, 31% e nxënësve thonë se nuk kanë mësimdhënës që ngacmojnë nxënësit, por 38% thonë se ka pak mësimdhënës që e bëjnë këtë, 21,7% thonë se disa mësimdhënës ngacmojnë nxënësit dhe 9,3% që thonë se ka shumë mësimdhënës që i ngacmojnë nxënësit. Shkollat duhet të jenë një hapësirë e sigurt për nxënësit në çdo aspekt, por kjo nuk është gjithmonë rasti me gjetjet e portretizuara deri më tani dhe kjo tendencë vazhdon, ku 39,5% thonë se përlëshja mes nxënësve në shkolla nuk ndodh kurrë, ndërsa 42,6% e nxënësve thonë se përlëshjet fizike ndërmjet nxënësve ndodhin një ose dy herë në javë, 9,3% thonë se ato ndodhin dy ose tre herë në javë ndërsa 3,1% thonë se ndodhin tre deri në katër herë në javë, 0,8% madje thonë se ndodhin katër deri në pesë herë në javë ndërsa 4,7% thonë se ndodhin më shumë se pesë herë në javë. Vlen të theksohet gjithashtu se 10,1% e nxënësve thonë se ngacmimi ndërmjet nxënësve nuk ndodh në shkollën e tyre, 38% thonë se ndodh ndonjëherë, 31% thonë se ndodh shpesh dhe një numër i konsiderueshëm prej 20,9% thonë se ndodh gjithmonë. Në atë linjë mendimesh 41,9% thonë se ngacmimi seksual nuk ndodh kurrë mes nxënësve në shkollën e tyre, 32,6% thonë se ndodh ndonjëherë, 15,5% thonë se ndodh shpesh dhe 10,1% thonë se ngacmimi seksual mes nxënësve ndodh gjithmonë në shkollën e tyre.


Unë mendoj se do të mund të shpëtoja nëse gjatë kohës që jam në shkollë do të ndodhte ndonjë emergjencë si zjarr apo tërmetet




Në shkollën time lehtëzi mund të kenë qasje nxënësit e shkollave tjera




Brenda shkollës ka kontrolle të rregullta nga policë civile ose policë të thjeshtë




Unë mendoj se është e lehtë qasja në substanca narkotike, në shkollë dhe/ose rreth saj




Rrugës për në shkollë dhe rreth saj ne rrezikohemi nga qentë endacakë




Në shkollë ka mësimdhënës që godasin nxënësit




Në shkollë ka mësime që ngacmojnë seksualisht nxënësit




Në shkollë ka mësime që ngacmojnë (bullizojnë) nxënësit




Në shkollë nxënësit grinden fizikisht me njëri tjetrin



Në shkollë ka nxënës që ngacmohen (bullizohen) nga nxënësit e tjerë




Në shkollë ka nxënës që ngacmojnë seksualisht nxënësit e tjerë




Në aspektin e shëndetit mendor, ishte e nevojshme përfshirja e pyetjeve në lidhje me mbështetjen psikologjike dhe shërbimet e shëndetit mendor në shkollë, veçanërisht për të parë nëse kuadri ligjor qëndron. Në këtë aspekt kemi një ndarje ku 58,1% e nxënësve thonë se është e vërtetë që kanë një psikolog në shkollë ndërsa 41,9% thonë se kjo nuk është e vërtetë. Nga ata që kanë një psikolog në shkollë 9,3% thanë se ishte shumë e pavërtetë që do t'i besonin psikologut/es, 16% thanë se ishte pjesërisht e pavërtetë që do t'i besonin, 18,7% thanë se ishte pjesërisht e vërtetë që do t'i besonin dhe 56% thanë se ishte shumë e vërtetë që do t'i besonin psikologut/es. Duke u zhytur më thellë në këtë temë, 24,3% raportuan se ishin konsultuar tashmë me psikologun në shkollën e tyre dhe 75,7% thanë se nuk ishin konsultuar deri më tani. Një gjetje interesante është se 14,9% e këtyre nxënësve thanë se ishte e vërtetë që mësuesi është konsultuar me psikologun në shkollë, ndërsa 12,2% thanë se kjo nuk ishte e vërtetë dhe 73% nuk e dinë nëse kjo është e vërtetë apo jo. Duke përcaktuar gjendjen mendore të këtyre nxënësve të përfshirë në këtë hulumtim, 13,2% prej tyre deklaruan se ishte shumë e pavërtetë që ndiheshin mirë emocionalisht në shkollë, 11,6% thanë se ishte e pavërtetë deri diku, 34,1% thanë se ishte herë pas here e vërtetë, 18,6% thanë se ishte e vërtetë deri diku dhe 22,5% e nxënësve thanë se ishte shumë e vërtetë që ndiheshin mirë emocionalisht në shkollë.

Një faktor tjetër që mund të ndikojë në shëndetin mendor të nxënësve është qasja verbale e mësimitdhënësve ndaj tyre, ku 32,6% thanë se ishte shumë e pavërtetë që ndiheshin të ofenduar nga fjalët e rënda dhe gjuha e ashpër e përdorur nga mësimitdhënësit ndaj tyre. 16,3% e nxënësve thanë se kjo ishte e pavërtetë deri diku, 21,7% e nxënësve thanë se ishte e vërtetë që ata ndjeheshin të ofenduar nga fjalët e rënda ose gjuha e ashpër e përdorur nga mësimitdhënësit herë pas here. Përkundrazi, 14% thanë se ishte deri diku e vërtetë dhe 15,5% thanë se ishte shumë e vërtetë që ndjeheshin të ofenduar nga sjellja e tillë e mësimitdhënësve.


Në shkollë ka psikolog/e të punësuar




Unë i do i besoja (besoj) psikologut/es së shkollës (për ndjenjat dhe mendimet e mija)




Unë jam konsultuar të paktën njëherë psikologun/en e shkollës




Mësimitdhënësit konsultohen me psikolog/en e shkollës



Unë ndihem mirë emocionalisht kur jam në shkollë




Ofendohem nga mësimitdhënësit (p.sh me fjalë fyese si: budalla, idiot)




16,3% e nxënësve thonë se është e vërtetë që kanë një bufe në shkollë ndërsa 83,7% thonë se kjo është e pavërtetë. Në një çështje të ngjashme 33,3% thonë se nxënësve u lejohet ushqimi dhe pijet prej jashtë shkollës, 66,7% thonë se nuk është kështu. Duke theksuar pjesëmarrjen e pakicave, 3,1% e nxënësve thonë se nxënësit nga grupet e marginalizuara nuk përfshihen kurrë në aktivitete shkollore, 9,3% thonë se at ndonjëherë përfshihen, 19,4% thonë se shpesh përfshihen, 35,7% thonë se ata janë gjithmonë të përfshirë, 25,6% nuk e dinë nëse këto komunitete janë të përfshira apo jo në shkollën e tyre dhe 7% nga nxënësit deklaruan se në shkollën e tyre nuk ka nxënës nga grupet e marginalizuara.

Ne kemi të dalura të përziera në pohimin e mëposhtëm, ku 47,3% thonë se është e vërtetë që ka pjerrina për qasje të karrigeve me rrota në shkollë dhe 52,7% thonë se kjo nuk është e vërtetë. Gjithashtu, 10,1% e nxënësve thonë se është e vërtetë që kanë banjo të qasshme për nxënësit me nevoja të veçanta ndërsa 89,9% thonë se kjo nuk është e vërtetë.


Kemi bufe në shkollë




Lejohen pijet dhe ushqimet nga jashtë brenda shkollës.




Nxënësit që i përkasin komuniteteve pakicë përfshihen në aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore



Në shkollë ka pjerrinë për qasje në shkollë për nxënësit ose mësimsdhënësit me aftësi të kufizuara




Në shkollë ka banjo të veçantë për nxënësit me aftësi të kufizuara




Roli i mësimsdhënësve kujdestar dhe prindërve ka qenë një pikë për t'u përmendur duke pasur parasysh rolin e tyre në mbarëvajtjen e proceseve shkollore. Duke pasur parasysh këtë, 10,1% thonë se kujdestarët dhe prindërit nuk luajnë kurrë një rol të rëndësishëm në vendimmarrje, 31% thonë se ndonjëherë luajnë një rol të rëndësishëm, 30,2% thonë se shpesh luajnë një rol të rëndësishëm dhe 28,7% thonë se ata gjithmonë luajnë një rol të rëndësishëm në vendimmarrje. Duke marrë parasysh gjetjet e lartpërmendura, nuk është për t'u habitur që 3,1% e nxënësve thonë se mësimsdhënësit nuk qëndrojnë kurrë në kontakt me kujdestarët dhe prindërit, 20,2% thonë kjo ndodh ndonjëherë, 24,8% thonë se kjo ndodh shpesh, 48,1% thonë se kjo ndodh gjithmonë dhe 3,9% nuk e dinë nëse mësimsdhënësit qëndrojnë në kontakt me prindërit dhe kujdestarët e klasëve.

12,4% e nxënësve thonë se nuk ka kurrë mundësi për nxënësit për t'u angazhuar në aktivitete, 22,5% thonë se ndonjëherë ka mundësi të tilla, 14,7% thonë se ka shpesh me 43,4% që thonë se ka gjithmonë mundësi për tu angazhuar në aktivitete dhe 7% që nuk e dinë nëse ka mundësi për t'u angazhuar në aktivitete apo jo. Kur bëhet fjalë për numrin e laboratorëve në shkollë, 1,6% e nxënësve raportojnë se në shkollë ka gjithsej 7 laboratorë, 0,8% raportojnë 6 laboratorë në shkollë, 10,6% raportojnë 5 laboratorë në shkollë, 23,6% raportojnë 4 laboratorë në shkollë, 22% thonë se janë 3 laboratorë në shkollë, 8,9% thonë se janë 2 dhe 32,5% thonë se ka vetëm 1 laborator në shkollë. Prej tyre, asnjë nxënës nuk raporton 7 laboratorë funksionalë në shkollë, 0,8% raportojnë 6 laboratorë funksionalë, 10,6 % raportojnë 5 laboratorë funksional, 17,1% raportojnë 4 laboratorë funksionalë, 22% thonë se 3 laboratorë janë funksionalë, 14,6% raportojnë 2 laboratorë funksional dhe 35% e nxënësve thonë se në shkollë punon vetëm 1 laborator.


Prindërit/kujdestarët janë zë i rëndësishëm në vendimet e shkollës.




Mësimdhënësit janë në kontakt me prindërit/kujdestarët ligjor.




Në shkollën time ekziston mundësia e angazhimit në aktivitete jashtë shkollore (p.sh klub i debatit, klubi i artit etj.)



Numri i laboratorëve në shkollë



Numri i laboratorëve funksional në shkollë



REZULTATET CILËSORE

Pavarësisht nga shumëllojshmëria e çështjeve të mbuluara në këtë pyetësor, një pjesë tjetër e rëndësishme që ia vlen të diskutohet është hapësira ku i kemi lejuar nxënësit të shtojnë komente shtesë ose të shtjellojnë më tej pikat e mbuluara gjatë hulumtimit. Ky seksion individualizon më tej raportet e veçanta duke reflektuar nevojat dhe shqetësimet specifike të nxënësve në nivel komune. Çështjet kryesore që u paraqitën si problematike kanë të bëjnë rreth sistemit të notimit, i cili shihet si i padrejtë nga disa nxënës. Sistemi i notimit lidhet jo vetëm me vetë notat, por edhe me peshën që u jep lëndëve të caktuara, ku nxënësit thanë se lëndët me rëndësi për aftësitë e tyre profesionale duhet të kenë rëndësi dhe vlerësim të ndryshëm në krahasim me lëndët që nuk kanë lidhje me fushën që ata vetë e kanë zgjedhur. Janë ngritur edhe shqetësime të tjera si sjellja e mësimdhënësve ndaj nxënësve, ku bullizmi përmendet sërish pavarësisht se është diskutuar në pyetësor. Jashtë shqetësimeve të sjelljes të përmendur më sipër, nxënësit përmendën gjithashtu sjelljen e stafit dhe drejtorëve në përgjithësi, por komentet ishin jospesifike në natyrën e tyre. Një theks i madh i kushtohet nevojës për renovime në shkolla. Kjo nuk është për t'u habitur duke marrë në konsideratë gjetjet për gjendjen aktuale të këtyre ambienteve, ku ka shumë punë që duhen bërë sidomos kur bëhet fjalë për banjot, klasat, muret e shkollave etj. Së fundi por jo për nga rëndësia janë deklaratat e nxënësve që ndihen sikur trajtohen ndryshe nga nxënësit e tjerë bazuar në prejardhjen e tyre, veçanërisht statusin dhe prejardhjen e prindërve të tyre. Kjo krijon një dinamikë jo të shëndetshme të vënë në dukje nga këta nxënës të cilët e shohin si të padrejtë dhe që natyrisht ndikon në gjendjen psikike dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor për ta.

D I S K

T I N

KU

M

DISKUTIM

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte matja e cilësisë në arsim përmes perceptimeve të nxënësve për përmbajtjen, procesin dhe mjedisin mësimor. Objektiva e parë ishte krijimi i një pyetësoi matës së perceptimit të cilësisë në arsim nga ana e nxënësve të shkollave të mesme të larta. Instrumenti i përdorur, sipas komenteve nga nxënësit ka treguar të jetë mjaft gjithëpërfshirës për matjen e perceptimit të nxënësve. Pra, është hap i mirë drejt krijimit të një modeli i cili mund të kthehet në standard të matjes së kësaj perspektive. Gjithsesi, sipas rekomandimeve nga nxënësit (të specifikuara në pjesën e kufiizimeve) duhet të shtohen dhe modifikohen disa dimensione, dhe instrumenti duhet të marrë një trajtë të matjes që në të ardhmen të matet vlefshmëria statistikore e tij. Tutje objektivi i dytë, ishte pasqyrimi i gjendjes në arsim në dimensionet e lartpërmendura. Hulumtimet e mëparshme të kryera nga KYC, organizata e institucione të tjera, shpesh kanë raportuar mospërmbushje të qëllimeve të strategjive, ligjeve e standardeve për arsimin para-universitar, në dimensione të ndryshme si: siguria, infrastruktura në shkollë, përmbajtja e mësimave, ligjërimi, dhuna në shkollë e shumë të tjera. Në këtë linjë qëndrojnë edhe të gjeturat e këtij raporti hulumtues.

PROCESI MËSIMOR

Një nga tre fushat kryesore në të cilat KYC e fokusoi këtë hulumtim është gjendja e procesit mësimor në shkollat e synuara. Të gjitha të dhënat e mbledhura tregojnë për rreth gjysmën e studentëve (44,2%) të cilët raportuan se vlerësohen gjithmonë ose shpesh në bazë të një burimi të vetëm. Rezultatet e tilla janë shumë shqetësuese duke pasur parasysh se bie ndesh drejtpërdrejt me Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e nxënësve (UA nr. 08/2016 Neni 3), pasi mësimdhënësit udhëzohen që të përdorin vlerësimin e vazhdueshëm si dhe atë përfundimtar për të arritur një notë më objektive. Ajo që gjithashtu nuk duhet të jetë e pranishme në sistemin e notimit është notimi i nxënësve në mungesë, ku një e pesta e nxënësve (20,9%) deklaruan se vlerësohen shpesh ose gjithmonë në mungesë. Në mënyrë të ngjashme, pothuajse dy të pestat e nxënësve (38,8%) deklaruan se ishin vlerësuar në bazë të notave nga lëndët e tjera. Prania e këtyre faktorëve në procesin mësimor të nxënësve peshojnë në efektivitetin dhe motivimin e të njëjtëve nxënës për të besuar vërtet se njohuritë e tyre po vlerësohen saktë.

Po aq i rëndësishëm është edhe interesimi i nxënësve për këto lëndë ku ata janë, ku mbi dy të pestat e nxënësve (44,8%) thonë se mënyrat e mësimdhënies janë shpesh të mërzitshme. Përdorimi i metodave moderne të mësimdhënies duhet të zbatohet në mënyrë që të jetë në përputhje me trendet moderne dhe mënyrat e komunikimit që gjeneratat e reja përdorin në jetën e tyre të përditshme. Pra, nuk është për t'u habitur që vetëm gjysma e studentëve (47,3%) kanë deklaruar se videot përdoren shpesh ose gjithmonë për mësimdhënie. Gjithashtu, mbi gjysma e të anketuarve (53,5%) deklaruan se mjetet konkretizuese përdoren nga mësimdhënësit shpesh ose gjithmonë. Për më shumë (61,3%) deklaruan se interaktiviteti është shpesh ose gjithmonë i rëndësishëm për mësuesit. Ndërsa më pak se gjysma e nxënësve (54,3%) thonë se klasat ndahen në grupe kur punojnë në detyra apo projekte. Duke pasur parasysh që pjesa tjetër e përgjigjeve (afërsisht gjysma) nuk janë pozitive, e kuptojmë se pse ka mungesë të interesimit për këto lëndë që nxënësit marrin. Megjithatë, pothuajse një e treta e nxënësve (31,8%) deklaruan se kanë mësimdhënës që mbajnë kurse private për të njëjtën lëndë që ata japin në shkollë. Kjo është diçka që duhet adresuar me zë pasi është një dukuri e madhe negative që krijon padrejtësi dhe pabarazi mes nxënësve, duke pasur parasysh që kurse të tilla janë të ndaluara.

MJEDISI MËSIMOR

Mjedisi mësimor është një nga kushtet kyçe e të mësuarit cilësor. Shëndeti dhe mirëqenia e nxënësve duhet të jetë një nga prioritetet kryesore të këtyre institucioneve arsimore, por fakti që 88,4% e nxënësve të intervistuar deklaruan se nuk kishin ujë të ngrohtë në banjo, me 92,2% që raportuan mungesë të pecetave në banjo dhe me 59,7% që raportojnë standarde johigjienike në banjo në përgjithësi tregojnë neglizhencën në këtë aspekt. Standardet higjienike të këtyre shkollave vihen sërish në pikëpyetje kur 46,6% e nxënësve raportojnë se shpesh ose gjithmonë ka një sasi të madhe mbeturinash në shkollë, ndërsa 64,4% e nxënësve raportojnë se nxënësit pinë duhan në shkollë herë pas here, shpesh ose gjithmonë, ndërsa të njëjtën gjë thonë për mësimdhënësit në 40,3% të rasteve si dhe për punëtorët e mirëmbajtjes në 33,3% të rasteve. Për më tepër, 45% e nxënësve e shohin të paktën deri diku të vërtetë që ata kanë qasje në lëndët narkotike në shkollë.

Rekomandimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë specifikojnë udhëzues dhe norma specifike për infrastrukturën brenda dhe përreth ndërtesave shkollore. Në përputhje me gjetjet nga studimi është e vështirë të besohet se këto janë ndjekur gjatë ndërtimit të të gjitha shkollave. Duke marrë parasysh pohimin e mësipërm, është shumë shqetësues fakti se 70,5% e nxënësve raportuan se nuk kanë dalje funksionale emergjente në shkollë. Një gjetje më pozitive është se vetëm 7,8% e nxënësve raportojnë se në shkollë nuk ka rrethojë.

Megjithatë, 44,2% e nxënësve thanë se është deri diku e vërtetë ose shumë e vërtetë që nxënësit e shkollave të tjera kanë qasje në objektin e shkollës së tyre që është një rrezik i drejtpërdrejtë kur bëhet fjalë për sigurinë e këtyre objekteve. Duke shtuar rreth sigurisë së shkollave të mesme të Prizrenit, 20,2% kanë deklaruar se shkolla e tyre nuk ka roje dhe nga ato që kanë, 92,2% kanë deklaruar se duhet t'i paguajnë vetë. 64,4% e nxënësve deklaruan se ndihen të kërcënuar nga qentë endacakë përreth shkollës. Gjithashtu vlen të theksohet se, 63,6% e nxënësve thanë se nuk ka pengesa rreth shkollës, 53,5% thonë se nuk ka vendkalime për këmbësorë dhe 69,8% e nxënësve deklaruan se makinat kalojnë pranë shkollës me shpejtësi të lartë, ku të gjitha këto vënë në pikëpyetje nivelin e sigurisë për të rinjtë e këtyre shkollave.

Gjithëpërfshirja e çdo studenti pavarësisht prejardhjes apo situatës së tij është një parim që duhet të jetë i pranishëm dhe praktikuar në çdo institucion arsimor, prandaj qasshmëria dhe gjithëpërfshirja është gjithmonë diçka që duhet pasur parasysh gjatë ndërtimit të këtyre hapësirave. Duke pasur parasysh këtë, 52,7% e nxënësve thonë se nuk ka rampë për studentët me nevoja të veçanta dhe 89,9% thonë se nuk ka banjo të qasshme për këto kategori.

Kur flasim për çështje të tjera siq janë hapësirat për lexim dhe mësimnxënie, 25,6% e nxënësve raportuan se shkolla e tyre nuk ka bibliotekë ndërsa nga ata që kanë 63,5% nuk kanë bibliotekar. Gjithashtu 39,6% e nxënësve kanë deklaruar se numri i librave nuk është i mjaftueshëm dhe 67,7% e nxënësve thonë se biblioteka nuk është e qasshme për mësim jashtë orarit të rregullt shkollor. Në të njëjtin mendim, 44,4% nuk e shohin se si këta libra janë të lidhur me klasat që kanë në shkollë. Edhe pse ka pasur një numër të laboratorëve të raportuar në shkolla, mospërputhja midis laboratorëve ekzistues dhe laboratorëve aktualisht funksionalë shihet lehtë. Gjersa 36,6% e nxënësve raportojnë 4 ose më shumë laboratorë në shkollë, vetëm 28,5% raportojnë se 4 ose më shumë laboratorë janë funksionalë në shkollë.

Gjersa nxënësit, veçanërisht fëmijët mbrohen ligjërisht nga çdo formë dhune (06 / L-084) dhe tashmë është vërtetuar se përjetimi i dhunës rrit gjasat e çrregullimeve të ndryshme mendore në të tashmen dhe të ardhmen (Perkins & Graham-Bermann, 2012), është bërë e qartë se sistemi arsimor përballet me mangësi serioze në përmbushjen e detyrimit për përmbushjen e këtyre përgjegjësive. Një përqindje alarmante prej 42,6% e nxënësve kanë raportuar se kanë përjetuar goditje të nxënësve nga mësimdhënësit, 27,1% e nxënësve kanë përjetuar ngacmime seksuale të bërë ndaj nxënësve prej mësimdhënëseve dhe 69% e nxënësve kanë qenë dëshmitarë të ngacmimeve të bëra ndaj nxënësve nga mësimdhënësit.

Në një rrjedhë të ngjashme, 67,4% e nxënësve thanë se ndonjëherë ndjehen të ofenduar nga fyerjet dhe nga gjuha e ashpër e përdorur nga mësimitdhënësit e tyre. Për më tepër, 60,5% e nxënësve janë dëshmitarë të përleshjeve të nxënësve me njëri-tjetrin më shumë se një herë në javë dhe 58,1% kanë raportuar se kanë qenë dëshmitarë të ngacmimeve seksuale mes nxënësve, ndërsa 89,9% kanë raportuar se nxënësit ngacmojnë apo bullizojnë njëri-tjetrin në shkollë. Prania e këtyre fenomeneve krijon perceptimin se shkollat jo vetëm janë një vend ku të nxënësit cilësor vihet në dyshim, por edhe normalizojnë dhunën si diçka që duhet të fshihet dhe jo të trajtohet.

Shëndeti fizik dhe ai mendor vijnë dorë për dorë, ndaj është për t'u habitur që 41,9% e nxënësve raportojnë se nuk ka psikolog në shkollë, pavarësisht se kjo kërkohet me ligj. Nga ata që raportuan se kishin një psikolog, 25,3% raportuan nivele të ulëta besimi ndaj psikologëve, ndërsa vetëm 24,3% e atyre që kanë qasje tek psikologët në shkollë janë konsultuar tashmë me ta të paktën një herë. Pra, nuk është shumë e habitshme që 58,9% e nxënësve raportuan se nuk ndiheshin mirë emocionalisht në shkollë shumicën e kohës. Mirëqenia mendore krijon bazën dhe mundësinë për nxënësit që të angazhohen plotësisht dhe të marrin udhën në rrugën e tyre edukative dhe profesionale.

PËRMBAJTJA MËSIMORE

Përmbajtja mësimore duhet të shërbejë si themeli i një procesi edukativ cilësor, prandaj ky seksion është gjithashtu i rëndësishëm për t'u theksuar dhe vënë në dukje. Është shumë shqetësues fakti që 80,6% e nxënësve kanë konfirmuar se ka gabime drejtshkrimore në tekstet shkollë që përdorin dhe 37,3% kanë gjetur gabime faktike në librat e tyre shkollë. Gjithashtu, 8,5% e nxënësve raportuan se librat e tyre shkollë nuk kanë informacion të përditësuar në to. Ndryshimet në sistemin arsimor nuk mund të pasohen me përditësimin e materialit që përdoret si bazë e studimeve të nxënësve, veçanërisht duke pasur parasysh ndryshimet që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit dhe informacionet e reja të mbështetura në fakte.

Duke vazhduar me përmbajtjen mësimore, 69% e nxënësve thanë se përdorin skripta në klasë, ndërsa 31,8% e nxënësve deklaruan se përdorin libra që nuk janë pjesë e kurrikulës dhe 70,5% e nxënësve raportuan se mësimitdhënësit i diktojnë mësimet, e cila ndërlidhet me përdorimin e metodave të vjetruara të mësimitdhënies nga mësimitdhënësit në këto shkolla të mesme.

Si një vlerësim i përgjithshëm nga nxënësit për studimet e tyre në përgjithësi, 18,6% e nxënësve mendojnë se mësimet nuk janë të dobishme për qëllimet e tyre afatgjata në arsim dhe 13,2% nuk mendojnë se mësimet në shkollë janë të dobishme në jetën e tyre të përditshme, ndërsa 25,6% nuk mendojnë se mësimet janë të dobishme për zgjidhjen e problemeve jashtë shkollës. 37,2% të tjerë nuk e shohin se shkolla i përgatit mirë për tregun e punës, gjë që është shumë për të ardhur keq pasi që ky duhet të jetë qëllimi dhe rezultati përfundimtar i këtyre studimeve tre vjeçare.

**PËR
FUND**

KUFIZIME

Duke qenë se ky studim ka dizajn kuantitativ të hulumtimit, vetë-raportimi është metodë kufizuese e të dhënave për shkak të subjektivitetit. Pasi një numrit të mostrës iu është administruar pyetësi, potencialisht prania e një personit të dytë gjatë përgjigjeve mund të ketë ndikuar në përgjigje. Tutje procedura e plotësimit të pyetësorve ka zgatur shumë, gjë që potencialisht mund të ketë ndikuar në vëmendjen dhe sinqeritetin e respondentëve. Edhe pas kalimit kontrollimit të pyetësorit në tri faza, nxënësit e përgjigjur kanë propozuar që dimensione të reja të shtohen në hulumtime të ardhshme si: uniforma, kutiat e ankesave, pedagogët, përfshirja e prindërve të fëmijëve të komuniteteve dhe qasja e stafit të shkollës. Prandaj në të ardhmen rekomandohen të përfshihen dimensionet e reja të propozuara.

Për shkak të numrit të ulët të mostrës nga komunitetet etnike dhe seksuale pakicë, nuk janë arritur të performohen analiza krahasuese. Së fundmi, kufizim i vazhdueshëm i studimeve me nxënës në Republikën e Kosovës, është mungesa e perspektivës së nxënësve të komunitetit serb. Numri i përfundimtar i pjesëmarrësve për komunë, ka qenë afër numrit ideal. Gjithashtu, zëri i nxënësve nga komuna e Mamushës, fatkeqësisht nuk ka arritur të përfaqësohet në këtë studim. Së fundmi, pasi hulumtimi ka pasur parimisht dizajn kuantitativ të hulumtimit, ne nuk mund të kuptojmë më në thellësi përvojat, sfidat dhe mendimet e nxënësve rreth cilësisë në arsim. Prandaj, hulumtimi me metodologji të përzier (cilësor dhe sasior) në të ardhmen do të zbuste këtë kufizim dhe do të hapte rrugë të reja të hulumtimit mbi cilësinë në arsim nga perspektiva e nxënësve.

REFERENCAT

- Arenliu, A., Kelmendi, K., Haskuka, M., Halimi, T., & Canhasi, E. (2013). Drug use and reported suicide ideation and attempt among Kosovar adolescents. *Journal of Substance Use*, 19(5), 358–363. doi:10.3109/14659891.2013.820803
- Buçaj, D. (2018). Koherenca e legjislacionit sekondarë me legjislacionin primarë në fushën e arsimit parauniversitar. Linku: <https://kosovotwopointzero.com/wp-content/uploads/2019/10/09-GIZ-Analize-Finale-Koherenca-e-legjislacionit-ALB-PRESS-QUALITY.pdf>
- Komiteti Ndërmistror për shkollat promovuese të shëndetit (2009). Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit në Kosovë 2009-2018. Linku: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/Stretegjia-per-ShPSH-ne-Kosove.pdf>
- KYC- Student Council of Kosovo (2010). Position paper on the Quality of Education
- KYC- Student Council of Kosovo (2016). Position paper on the Quality of Education. Linku: https://issuu.com/sadrishehu5/docs/qknk_al?fbclid=IwAR0n3DgwHDuwNNBgqFDEVqYu1tbq5t2_VKAW2a9bmVMbiCrKnME73tzu0JM
- Ligji për Arsimin Parauniversitar. Nr. 04/L-032 (2016). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, Nr. 06/L-084 (2019). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>
- Mekolli, S. (2015) Dhuna dhe Siguria në Shkolla. Instituti Pedagogjik i Kosovës. Linku: <https://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/12/Dhuna-dhe-siguria-ne-shkolla.pdf>
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2007) Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007-2017. Linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/strategjia-per-zhvillimin-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove.pdf>
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) - Misioni në Kosovë (2018). Qasja e Komuniteteve në Arsimin parauniversitar në Kosovë. Linku: https://www.osce.org/files/Community%20Education%20report_Albanian_layout.pdf
- Organization for Economic Co-operation and Development – OECD (2019) How did countries perform in PISA 2018?. Linku: <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/28450521-en.pdf?expires=1648170328&id=id&accname=guest&checksum=9F7D184DC2C63DB19436D9AB638EF0D9>

- Perkins, S., & Graham-Bermann, S. (2012). Violence exposure and the development of school-related functioning: Mental health, neurocognition, and learning. *Aggression and Violent Behavior, 17*(1), 89–98. doi:10.1016/j.avb.2011.10.001
- Udhëzimi administrativ Nr. 08/2016 për Vlerësimin e Nxënësve (2016). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/ua-nr-08-2016-per-vleresimin-e-nxeneseve_1.pdf
- Udhëzimi Administrativ Nr. 32/2013 për Organizimin e Kurrikulës me Zgjedhje (2013). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10157>
- Udhëzimi administrativ Nr. 34/2014 për Funkionimin e Shërbimeve Pedagogjike-Psikologjike në shkolla. (2014). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-34-2014.pdf>
- Udhëzuesi për Normat dhe Standardet e Ndërtesave Shkollore (2015). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/masht-vol1-alb-print-5mm-bleed-0mm-inside-final_1.pdf
- Uka, F., Bërxulli, D., Hasani, A., Peci, B., Taravari, G., & Wium, N. (2021). , And Among in , , and. In R. Dimitrova & N. Wium (Eds.), *Handbook of Positive Youth Development* (pp. 135–151). Springer International Publishing. https://doi.org/10.1007/978-3-030-70262-5_10

Shtojcë I

PYETËSORI PËR MATJEN E CILËSISË SË EDUKIMIT NGA PERCEPTIMI I NXËNËSVE TË SHKOLLIMIT TË MESËM TË LARTË

Qëllimi i pyetësorit për matjen e cilësisë së edukimit nga perceptimi i nxënësve të shkollimit të mesëm të lartë është të kuptojë problemet dhe shqetësimet kryesore të nxënësve në dimensione të ndryshme të cilat sigurojnë cilësi, siç janë: librat, lëndët zgjedhore, mënyra e vlerësimit dhe ligjërimit, përmbushjen e qëllimeve personale të edukimit, laboratorët, zhurma, siguria në shkollë, higjiena, ndriçimi, biblioteka, shëndeti mendor, ushqimi, gjithëpërfshirja dhe përfshirja e prindërve/kujdestarëve.

1.Komuna		
2.Vendbanimi	Urban Rural	
3.Emri i shkollës dhe drejtimi		
4.Aftësi e kufizuar	Po Jo	
5.Klasa	X	
	XI	
	XII	
5. Gjinia	Vajzë Djalë Tjetër	
6.Orientimi seksual	Hetereoseksual (tërhiqem nga seksi i kundërt)	
	Gej (djem që tërhiqen nga djemtë)	
	Lezbike (vajza që tërhiqen nga vajza)	
	Biseksual (tërhiqen nga më shumë se një gjini)	
	Panoseksual (tërhiqen nga dikush pavarësisht gjinisë)	
	Preferoj të mos përgjigjem	
	Tjetër	
7.Etnia	Shqiptar	
	Ashkali	
	Serb	
	Turk	
	Rom	
	Egjiptian	
	Boshnjak	
Përmbajtja e librave	8.Unë kam vërejtur se tekstet e librave përmbajnë gabime drejtshkrimore.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
	9.Unë kam vërejtur se tekstet e librave përmbajnë gabime faktike.	3-E vërtetë deri diku
	10.Unë kam vërejtur se tekstet e librave nuk janë të rifuqësuar me informata të reja,	4- Shumë e vërtetë
Përdorimi i librave	11.Ne përdorim libra për çdo lëndë mësimore.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
	12.Ne përdorim skripta për të mësuar lëndët.	3-E vërtetë deri diku
	13..Ne përdorim libra të cilat nuk janë pjesë e kurrikulës.	4- Shumë e vërtetë

Notimi	14.Unë kam marrë notë duke u vlerësuar vetëm nga një burim (me gojë, shkrim ose aktivitet) dhe jo kombinim	1-Asnjëherë
	15.Unë kam marrë notë vetëm në bazë të sjelljes sime gjatë orës së mësimit dhe jo dijes.	2-Rrallë
	16.Unë jam notuar pa prezencën time.	3-Shpesh
	17.Unë jam notuar në një lëndë në bazë të notave në lëndë të tjera.	4- Gjithmonë
Praktikat e ligjërimit	18.Unë mendoj se mënyra e ligjërimit të lëndëve është e mërzitshme (boring).	1-Asnjëherë
	19.Mësimdhënësit gjatë ligjërimit përdorin video për të ilustruar më mirë mësimin.	2-Rrallë
	20.Mësimdhënësit përdorin mjete konkretizuese për shpjegimin e lëndëve (p.sh mësimdhënësi/ja e gjeografisë përdorë hartë, profesori i kimisë përdorë epruvetë).	3-Shpesh
	21.Mësimdhënësit i kushtojnë rëndësi interaktivitetit përmes diskutimeve.	4- Gjithmonë
	22.Mësimdhënësit kalojnë më shumë se gjysmën e orës duke ndarë informata nga jeta personale dhe jorelevante me temën.	
	23.Mësimdhënësit japin vetëm shënime.	
	24.Mësimdhënësit ndajnë klasën në grupe për të punuar për detyra/projekte.	
	25.Ne kemi mësimdhënës të cilët mbajnë kurse private për lëndën që ligjërojnë në shkollë.	
	26.Neve na u është diktuar mësimi nga mësimdhënësit ose nga dikush që ata kanë përcaktuar.	
Qëllimet personale të edukimit	27.Unë mendoj se mësimet në shkollë i kontribuojnë qëllimeve të mia afatgjate në edukim.	1-Aspak e vërtetë
	28.Unë mendoj se mësimet në shkollë janë të dobishme.	2-E pavërtetë deri diku
	29.Unë mendoj se mësimet në shkollë më ofrojnë mundësi të zgjedh probleme në të ardhmen.	3-E vërtetë deri diku
	30.Unë mendoj se programi i shkollës më ka përgaditur shumë për tregun e punës.	4- Shumë e vërtetë
Ndriçimi dhe klima	31.Në shkollë dhe në klasa ka mjaftueshëm ndriçim.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
	32.Në shkollë është ngrohtë mjaftueshëm dimrit.	3-E vërtetë deri diku
	33.Në shkollë është freskët mjaftueshëm verës.	4- Shumë e vërtetë
Pirja e duhanit në shkollë	34.Nxënësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës.	1-Asnjëherë
		2-Rrallë
		3-Ndonjëherë
	35.Mësimdhënësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës.	4-Shpesh
	36.Punëtorët teknikë & mirëmbajtësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës.	4- Gjithmonë

Perceptimi i sigurisë në shkollë	37.Unë mendoj se do të mund të shpëtoja nëse gjatë kohës që jam në shkollë do të ndodhte ndonjë emergjencë si zjarr apo tërmet.	1-Shumë e vërtetë
	38.Në shkollën time lehtëzi mund të kenë qasje nxënësit e shkollave tjera.	2-E vërtetë deri diku
	39.Brenda shkollës ka kontrola të rregullta nga policë civile ose policë të thjeshtë.	3-E pavërtetë deri diku
	40.Unë mendoj se është e lehtë qasja në substanca narkotike, në shkollë dhe/ose rreth saj.	4- Aspak e vërtetë
	41.Rrugës për në shkollë dhe rreth saj ne rrezikohemi nga qentë endacakë.	
	42. Në shkollë ka shkallë emergjente funksionale	1-E vërtetë
	43. Shkolla ime është e rrethuar (ka rrethojë)	2- E pavërtetë
	44. Ne kemi roje sigurimi në shkollë	
	45, Nëse po: Unë paguaj për rojet e sigurimit në shkollë	
Dhuna nga mësimitdhënësit	46.Në shkollë ka mësimitdhënës që godasin nxënësit.	1-Asnjë mësimitdhënës
		2-Pak mësimitdhënës
	47.Në shkollë ka mësimitdhënës që ngacmojnë seksualisht nxënësit.	3- Disa mësimitdhënës
	48.Në shkollë ka mësimitdhënës që ngacmojnë (bullizojnë) nxënësit.	4-Shumë mësimitdhënës
Dhuna në mes të nxënësve	49.Në shkollë nxënësit grinden fizikisht me njëri tjetrin.	1-Asnjëherë
		2-Një deri dy herë në javë
		3-Dy deri tri herë në javë
		3-Tri deri katër herë në javë
		4-Katër deri pesë herë në javë
		5-Më shumë se 5 herë në javë
	50..Në shkollë ka nxënës që ngacmohen (bullizohen) nga nxënësit e tjerë.	1-Asnjëherë
		2-Rrallë
		3-Shpesh
	51.Në shkollë ka nxënës që ngacmojnë seksualisht nxënësit e tjerë.	4- Gjithmonë
Përfshirja e prindërve në shkollë	52.Prindërit/kujdestarët janë zë i rëndësishëm në vendimet e shkollës.	1-Asnjëherë
		2-Rrallë
		3-Shpesh
	53.Mësimitdhënësit janë në kontakt me prindërit/kujdestarët.	4- Gjithmonë

Lënda zgjedhore	54.Unë kam pasur mundësinë të zgjedh lëndën zgjedhore.	1-Asnjëherë
		2-Rrallë
		3-Shpesh
		4- Gjithmonë
	55.Në shkollën time janë funksionale: (shkruaj laboratorët dhe sallat funksionale).	
Bibloteka	56.Ne kemi bibotekë në shkollë.	1-E vërtetë
		2- E pavërtetë
	57. Nëse po, biblioteka ka bibliotekist/e	1-E vërtetë
		2- E pavërtetë
	58,Nëse po: Biblioteka në shkollë ka numër të mjaftueshëm të librave.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
	59.Biblioteka në shkollë është e qasshme për të mësuar pas mësimit.	3-E vërtetë deri diku
	60.Librat në bibliotekë përkojnë me mësime/moshën/nivelin tonë akademik.	4- Shumë e vërtetë
Zhurma	61.Zhurma përreth objektit të shkollës dëmton procesin mësues në klasë.	1-Asnjëherë
	62.Mësimdhënësit nuk arrijnë të menaxhojnë zhurmën në klasë.	2-Rrallë
	63.Mësimdhënësit janë shkaktarë të zhurmës në klasë.	3-Shpesh
	64,Nxënësit janë shkaktarë të zhurmës në klasë.	4- Gjithmonë
Trafiku afër shkollës	65.Afër shkollës ka policë të shtrirë (pengesa për qëllim të ngadalësimit të shpejtësisë).	1-E vërtetë
	66.Afër shkollës ka vija të bardha për kalim të sigurt të rrugës.	2- E pavërtetë
	67.Afër shkollës kalojnë vetura me shpejtësi të madhe që rrezikojnë mirëqenien tonë.	
Higjiena	68.Në banjot e shkollës ka ujë të ngrohtë.	1-E vërtetë
		2- E pavërtetë
	69.Në banjot e shkollës ka peceta.	
	70..Në banjot e shkollës ka detergjent për larjen e duarve.	
	71. Në klasë ka numër të madh të mbeturinave.	
	72. Në shkollë ajri është i pastër	1-Asnjëherë
	73. Ka lagështi te muret (myk).	2-Rrallë
	74. Nxënësit mirëmbajnë klasën (hedhin mbeturinat në shportë	3-Shpesh
	75. Mirëmbajtësit në shkollë kryejnë punën ashtu siç duhet.	4- Gjithmonë

Infrastruktura	76.Bankat, karriget dhe dyert në shkollë janë në gjendje të rregullt.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
		3-E vërtetë deri diku
		4- Shumë e vërtetë
Siguria në shkollë	77.Në shkollë ka shkallë emergjente funksionale	1-E vërtetë
	78.Shkolla ime është e rrethuar (ka rrethojë)	2- E pavërtetë
	79.Ne kemi roje sigurimi në shkollë	
	80. Nëse po: Unë paguaj për rojet e sigurimit në shkollë	
Shëndeti mendor	81.Në shkollë ka psikolog/e të punësuar.	1-E vërtetë
		2- E pavërtetë
	82.Nëse po: Unë i besoj psikologut/es së shkollës (për ndjenjat dhe mendimet e mija)	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
		3-E vërtetë deri diku
	83.Nëse po: Unë ndihem mirë emocionalisht kur jam në shkollë.	4- Shumë e vërtetë
	84..Ofendohem nga mësimdhënësit (p.sh me fjalë fyese si: budalla, idiot/e).	1-Asnjëherë
		2-Rrallë
		3-Shpesh
		4- Gjithmonë
Ushqimi	85.Kemi bufe në shkollë.	1-E vërtetë
	86.Lejohen pijet dhe ushqimet nga jashtë brenda shkollës.	2- E pavërtetë
Gjithëpërfshirja	87.Nxënësit që i përkasin komuniteteve pakicë përfshihen në aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore.	1-Asnjëherë
		2-Ndonjëherë
		3-Shpeshherë
		4-Gjithmonë
		5-Nuk e di
		6-Nuk ka nxënës të komunitetit pakicë në shkollën time
	88.Në shkollë ka pjerrinë për nxënësit ose mësimdhënësit me aftësi të kufizuara .	1-E vërtetë
	89Në shkollë ka banjo të veçantë për nxënësit me aftësi të kufizuara.	2- E pavërtetë
Aktivitetet jashtë shkollore	90.Në shkollën time ekziston mundësia e angazhimit në aktivitete jashtëshkollore (p.sh klub i debatit, klubi i artit etj.)	1-Asnjëherë
		3-Rrallë
		3-Shpesh
		4-Gjithmonë
		5-Nuk e di
Komente/propozime		

Shtojcë II

Mostra përfundimtare dhe ndarja për komuna

Nr i nxënësve për komunë	Komuna	Numri i shkollave në komunë	Total
42	Artanë	1	11
1435	Burim	2	16
935	Dardanë	3	30
1063	Deqan	2	35
525	Sharr	1	10
2487	Drenas	2	22
1528	Fushë Kosovë	3	35
6018	Ferizaj	8	126
3858	Gjakove	6	127
4408	Gjilan	9	137
303	Hani Elezit	1	10
190	Junik	1	10
1163	Kacanik	2	17
703	Kastriot	2	12
1446	Kline	2	19
2585	Lipjan	3	42
2268	Malisheve	3	34
167	Mamushe	0	0
3886	Mitrovice	5	62
3909	Peje	6	110
3863	Podujeve	3	88
10020	Prishtine	14	212
6503	Prizren	7	129
1620	Rahovec	4	38
120	Shtërpçë	1	12
1152	Shtime	1	24
2062	Skenderaj	3	60
2088	Therandë	3	35
1716	Viti	2	35
2679	Vushtri	3	37
70742	TOTAL		1535

